



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.162/1 prot.

Tiranë më 17.01.2023

REKOMANDIM

Nr. 02, datë 17.01.2023

PËR KONTROLLUESIN “MIA FINANCE SHA”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Mia Finance sha (ish-Capital Invest sha)” (në vijim, “Kontrolluesi),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 185, datë 19.10.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI).*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi ushtron veprimtarinë në fushën e shërbimeve financiare, si institucion financiar i mikrokredisë dhe ofron shërbime këshilluese për kredidhënien, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për veprimtarinë e institucioneve jobankare. Me vendim të asamblesë së përgjithshme të aksionerëve, është vendosur ndryshimi i emrit të kontrolluesit nga “Capital Invest” në “MIA Finance”.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave personale “klientët”, “punonjës”, “aksionerë”, “vizitorë”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi mbledh dhe ruan të dhëna personale, nëpërmjet krijimit të dosjeve fizike, për subjektet e të dhënave personale klientë, në rastet e çeljes së një kredie financiare dhe praktikave të tjera ligjore. Të dhënat, që mbliidhen për subjektin e të dhënave, janë: “emër, mbiemër, atësi, numër identifikimi, numër telefoni, adresa, profesioni, etj.”.

Përpunimi i të dhënave personale nga Kontrolluesi bëhet në rrugë manuale, nëpërmjet krijimit të dosjeve fizike të kredimarrësve, si dhe në rrugë elektronike, nëpërmjet sistemit online “MIA Finance”.

Sistemi online “MIA Finance”, ofrohet nga kontrolluesi, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë, edhe nëpërmjet degëve/agjentëve. Sistemi është i përbërë nga module të tilla, si: “Klientët”, “Kreditë”, “Arka” dhe “Administrimi”. Rolet e përdoruesve në sistem janë: “Arkëtar”, “Oficer kredie”, “Oficer kredie dhe Arkëtar”, “Back Office/ekonomist”, “Oficer kredie dhe ekonomist”, “Ekonomist special”, “Viewer”, “Super user”, “Administrator”.

Gjatë procesit të regjistrimit të klientit në sistem, Kontrolluesi regjistron të dhënat si, “emër, mbiemër, atësi, numër identifikimi, datëlindja, numër dokumenti, shtetësi, numër telefoni, lloji i telefonit, numër telefoni i dytë, të ardhurat, adresa, profesioni, arsimit, e-mail, gjendja e plotë civile, etj.”

Kontrolluesi nuk ka përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave të mësipërme, në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së të dhënave personale, parashikuar në germën “d”, të pikës 1, të nenit 5, të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me të dhënat personale të grumbulluara gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Kontrolluesi duhet të parashikojë ruajtjen e të dhënave personale të grumbulluara, në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e grumbullimit të informacionit.

3. Kontrolluesi ka të instaluar një sistem video survejimi (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme, për qëllim të sigurisë së aseteve. Sistemi i video survejimit CCTV monitoron brenda zyrave të punonjësve, gjatë orarit të aktivitetit të tyre zyrtar të punës.

Zyra e Komisionerit vlerëson se survejimi i punonjësve në vendin e punës është në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për

përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit si dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 “Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar (në vijim, “udhëzimi nr. 11”), i cili në pikën 10.2 të tij parashikon se kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikqyrjen e një punonjësi në vendin e punës.

4. Në ambientet e brendshme të shoqërisë, janë vendosur tabela njoftuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV, por tabelat nuk përmbajnë elementët informues, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar (në vijim, udhëzimi nr. 3).

Konstatohet se, në dokumentin tip për “Kërkesë për Kredi”, Kontrolluesi nuk ka të parashikuar një rubrikë në mënyrë që të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale. Subjektet e të dhënave personale nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të ligjit.

Në faqen zyrtare www.capitalinvest.com.al, Kontrolluesi nuk ka marrë masa për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet publikimit të “Politikave të Privatësisë”, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja, sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Kur mbledh të dhëna personale, Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij, etj.

5. Kontrolluesi disponon akt-marrëveshjen me nr. 68/6 prot., datë 23.06.2022, të lidhur me “Raea Financial Services SHPK”. Objekti i kësaj kontrate është ofrimi i shërbimit për klientët e mundshëm, nga ana e agjentëve të “RAEA Finance Services”, për kreditë e ofruara nga Capital Invest. Në nenin 8 të marrëveshjes, parashikohet “Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale”.

Konstatohet se, dispozita nuk është shteruese në drejtim të detyrimeve që duhet të parashikojë midis kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas nenit 20 të Ligjit. Gjithashtu, marrëveshja nuk ofron garanci të plota për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale për palët kontraktore, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012, të Komisionerit mbi “Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe

përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Gjithashtu, Kontrolluesi ka lidhur akt-marrëveshje me subjektin A. M. (person fizik), në datën 13.11.2021, me objekt ndërtimi i sistemit informatik për procesin e kredidhënies, menaxhimit të kredive dhe pagesës, për Capital Invest SH.A. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kësaj kontrate, Zyra e Komisionerit konstaton se nuk janë parashikuar detyrimet e nenit 20 të ligjit dhe Udhëzimit nr. 19.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës, të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave.

Sipas përcaktimeve të Udhëzimit të sipërcituar, çdo kontratë përpunimi (*outsourcing*), që ka për qëllim përpunimin e të dhënave personale, duhet të përmbajë dispozita konkrete që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit shqiptar. Çdo kontratë e tillë, duhet të parashikojë çdo masë që merr përpunuesi për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave.

6. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se kontrolluesi ka “njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, megjithatë është konstatuar se “Njoftimi” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit, si vijon:

- Deklarimin në rubrikën 1, të formularit të njoftimit “*Të dhënat e subjektit kontrollues*”;
- Deklarimi në rubrikën 3, të formularit të njoftimit “*Kategoritë e subjekteve të dhënave personale që përpunohen*”;
- Deklarimi në rubrikën 7, të formularit të njoftimit “*Marrësi i të dhënave personale*”;
- Deklarimi në rubrikën 8, të formularit të njoftimit “*Transferim ndërkombëtar i të dhënave personale*”;
- Deklarimi në rubrikën 9, të formularit të njoftimit: “*Mjetet e përpunimit të të dhënave*”;
- Deklarimi në rubrikën 10, të formularit të njoftimit: “*Masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale*”;

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përmbushja e detyrimit për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

7. Kontrolluesi disponon rregullore “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, por konstatohet se ajo nuk parashikon të gjitha proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

8. Kontrolluesi ka miratuar një grup politikash lidhur me sigurinë e informacionit. Konkretisht, ka hartuar :

- a) Politikat e ruajtjes së të dhënave;
- b) Politikat e përdorimit të pranueshëm;
- c) Politikat e sigurisë së Internetit;
- d) Politikat e pajisjeve të lëvizshme;
- e) Politikat e postës elektronike;
- f) Politikat e mbrojtjes nga viruset;
- g) Plani i reagimit nga incidenteve;
- h) Politika e programeve;
- i) Politikat e aksesit në Datacenter;
- j) Konvencionet e emërtimeve të pajisjeve MIA Finance;
- k) Politika e mbrojtjes së fjalëkalimit;
- l) Menaxhimi i përdoruesve në sistem.

Megjithatë, konstatohet se mungojnë elementë të tjerë të sigurisë së të dhënave si, “Analiza e sigurisë së sistemit të arkivimit”, “Raport vlerësimi mbi sigurinë në sistemin e arkivimit”, etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, zbatueshmëria dhe dokumentimi i procedurave dhe politikave në lidhje me sigurinë e informacionit, është një ndër masat kryesore që duhet të ndërmerret Kontrolluesi, në lidhje me sigurinë dhe funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura, sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit, me qëllim ndërgjegjësimin e operatorëve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Gjithashtu konstatohet se masat e ndërmarra nga Kontrolluesi janë ta pamjaftueshme në raport me veprimtarinë e gjerë që kryen. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*), për shkak cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47. SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ndërkombëtar ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5, të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 48”*), si dhe duhet të jetë një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48 të Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare, nëpërmjet shkresës nr. 2012/3 prot., datë 22.12.2022.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore datë 05.01.2023, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe kanë deklaruar angazhimin për rikuperimin e

shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar, si dhe kanë paraqitur argumentet si vijon:

1. Në lidhje me afatin e ruajtjes së të dhënave personale, i cili bazohet në qëllimin e përpunimit të të dhënave, bëjmë me dije se dokumentimi i tyre për asgjësim dhe afati i përcaktuar në rregullore do të parashikohet në vijim;
2. Sa i përket kamerave të vendosura në ambientet e MiA Finance, është sistemuar rrezja e shikimit të kamerave të drejtuara, kryesisht në hyrje-daljen e ambientit, si masë mbrojtëse e ndonjë dëmtimi të mundshëm të mjediseve të MiA Finance, duke marrë në konsideratë asetet dhe dokumentacionin e institucionit;
3. Institucioni ka marrë masa për vendosjen e tabelave njoftuese mbi prezencën e sistemit tëurvejimit, sipas specifikave të kërkuara dhe ka vënë në dijeni stafin e saj, sipas Udhëzimit nr. 11;
4. Sipas konstatimit për dokumentin tip *“Kërkesë për kredi”* dhe mënyrën e informimit të subjekteve për përpunimin e të dhënave personale, argumentojmë se dokumenti që ju është vënë në dispozicion ka qenë draft, i cili është përfunduar, por deri tani nuk është vënë në përdorim. Gjithashtu, faqja e internetit është ndryshuar nga capitalinvest.com.al, në përmbushje të detyrimit për informim të subjekteve të të dhënave personale. Deri në këto momente, aplikimi i klientit është bërë sipas të dhënave të formularit online.
5. Sipas konstatimit, në lidhje me akt-marrëveshjen lidhur me RAEA Financial Services shpk, institucioni është duke finalizuar aneks kontratën, sipas udhëzimit nr. 19 të Komisionerit;
6. Sa i përket njoftimit, institucioni rishikoi dhe përpunoi formularin, i cili u dorëzua në protokollin e Zyrës së Komisionerit.
7. Sa i përket konstatimit për *“Analizën e sigurisë së sistemit të arkivimit”*, *“Raport vlerësimit mbi sigurinë e sistemit të arkivimit”*, MiA Finance është në kuadër investimi në sistemin e sigurimit dhe në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, si dhe do të organizohen trajnime për stafin e institucionit, në lidhje me procesin në tërësi dhe në veçanti me ndryshimet e fundit të rregulloreve dhe proceseve të secilit anëtar të stafit, për të cilat në vijim do të njihet edhe Zyra e Komisionerit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/l”), si dhe 32 të ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, të marrë masa për shkatërrimin e të dhënave të ruajtura/mbledhura në tejkalim të qëllimit të përpunimit për të cilat janë mbledhur;
2. Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19;
5. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit”, në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.
8. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:
 - (i) brenda 5 (pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 1 më sipër;
 - (ii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikat 2, 3 dhe 5 më sipër;
 - (iii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 4 dhe 6 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 7 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
10. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 17.01.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi